



Në bazë të nenit 11 dhe nenit 35, paragrafi 1.1, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Bordi i Bankës Qendrore, në mbledhjen e mbajtur më datën 25 prill 2019, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR RIBLERJE TË LETRAVE ME VLERË ME BANKËN QENDRORE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 1

Qëllimi dhe Fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj rregullore është të përcaktoj kushtet dhe kriteret që duhet të përmbushet nga një bankë bazuar në kërkesën për asistencë nga huadhënia e mbështetur me kolateral të letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës përmes ekzekutimit të një marrëveshje riblerjeje me Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK). Qëllimi i kësaj huadhënie është të ndihmojë bankat anëtare në menaxhimin efikas të likuiditetit të tyre në periudhën afatshkurtër. Marrëveshja Kryesore e Përgjithshme për Riblerje e autorizon BQK-në të kryejë operacione kreditore me bankat komerciale që veprojnë në Kosovë përmes huadhënies së mbështetur me kolateral.
2. Kjo rregullore aplikohet për të gjitha bankat dhe degët e bankave të huaja të licencuara nga BQK-ja për të operuar në Republikën e Kosovës.

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjitha termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në Nenin 3 të Ligjit nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare jo Bankare" (në vijim: Ligji për banka), dhe/ose sipas përkufizimeve në vijim për qëllimin e kësaj rregulloreje:
 - 1.1. **Bono Thesari** - nënkupton letrat me vlerë të tregtueshme të emetuara nga Qeveria e Kosovës me afat maturimi prej një viti ose më pak. Këto letra me vlerë shiten me zbritje nga vlera në të parë;

- 1.2. **Obligacionet Qeveritare** - nënkupton letrat me vlerë të tregtueshme të emetuara nga Qeveria e Kosovës me afat maturimi më të gjatë se një vit. Këto letra paguajnë interes dhe zakonisht mbajnë kupona me normë fiks;
- 1.3. **Kolaterali** - nënkupton Bonot e Thesarit dhe Obligacionet Qeveritare të tregtueshme të Qeverisë së Kosovës të cilat përdoren si peng për mbështetje të likuiditetit;
- 1.4. **Marrëveshja për Riblerje (Repo)** - nënkupton një marrëveshje midis dy palëve, me anë të së cilës njëra palë bie dakord t'i shesë palës tjetër një letër me vlerë specifike për një periudhë të caktuar kohore sipas marrëveshjes Repo të së njëjtës letër me vlerë në të ardhmen sipas çmimit dhe afatit të maturimit për të cilat janë pajtuar të dyja palët.;
- 1.5. **Norma Bazë** - nënkupton norma e rifinancimit të Bankës Qendrore Evropiane, e cila është baza për normën Repo për operacionin e huadhënies së mbështetur me kolateral nga ana e BQK-së;
- 1.6. **Rregullimi i Diferencës** - nënkupton shuma e normës së interesit të shtuar në normën bazë për të llogaritur normën Repo nga huadhënia e mbështetur me kolateral nga ana e BQK-së. Rregullimi i diferencës do të përcaktohet nga BQK;
- 1.7. **Huamarrësit** - nënkupton bankat dhe degët e bankave të huaja të licencuara nga BQK-ja për të operuar në Republikën e Kosovës;
- 1.8. **Huadhënësi** - nënkupton BQK;
- 1.9. **Norma Repo** - nënkupton Norma e interesit e ngarkuar nga huadhënësi tek huamarrësi për shumën e mjeteve monetare të huazuara gjatë kohëzgjatjes së marrëveshjes Repo. Norma Repo nga huadhënia e mbështetur me kolateral është norma bazë e shtuar me normën nga rregullimi i diferencës, dhe e cila caktohet nga BQK. Interesi kalkulohet duke shfrytëzuar numrin aktual të ditëve me bazë 360 ditë;
- 1.10. **Llogaria për Repo e BQK-së** - nënkupton llogaria e mjeteve në pasqyrat financiare të BQK-së e cila pasqyron mbajtjen e kolateralit të specifikuar gjatë kohëzgjatjes së marrëveshjes Repo.
- 1.11. **Dorëzimi Kundrejt Pagesës (DVP)** - nënkupton sistemi i shlyerjes që nënkupton shkëmbimin e kolateralit dhe të pagesës në mënyrë të njëkohshme;
- 1.12. **Depo/X** - nënkupton sistemi i regjistrimit kontabël që mundëson emetimin, regjistrimin, shitjen dhe transferimin elektronik të letrave me vlerë të Qeverisë në BQK;
- 1.13. **Data e përfundimit** - nënkupton data e shlyerjes nga maturimi i marrëveshjes Repo, me ç'rast kryegjëja dhe interesi për t'iu paguar Huadhënësit bëhet nga llogaria e Huamarrësit në BQK;
- 1.14. **Margjina** - nënkupton margjina ose diferenca që paraqet kolateralin shtesë të kërkuar nga mbajtësi i kolateralit në një marrëveshje Repo. Kjo marginë ose diferencë kërkohet për të mbrojtur kolateralin nga rënia e mundshme e çmimit;

- 1.15. **Çmimi i Plotë Akruar** - nënkupton çmimin e duhur të obligacioneve qeveritare për një marrëveshje Repo duke shtuar çmimin e tregut dhe interesin e përlllogarit/akruar së bashku para se të bëhet zbritja bazuar në kërkesën për margjinë;
- 1.16. **Shuma Nominale** - nënkupton vlera nominale ose vlera në të parë, që është vlera e treguar në një letër me vlerë qeveritare, duke përfshirë edhe valutën e saj;
- 1.17. **Data e Maturimit të Repo** - nënkupton Dita kur afati i fundit i një marrëveshje Repo ka afatin maksimal të maturimit prej dhjetë (10) ditë. Kohëzgjatja e marrëveshjes Repo mund të ndryshohet ashtu siç do të përcaktohet nga BQK;
- 1.18. **Përfundimi i marrëveshjes Repo** - nënkupton një marrëveshje Repo e cila përfundon në datën e maturimit të përcaktuar fillimisht sipas kushteve të marrëveshjes Repo. Në raste tjera, një marrëveshje Repo mund të përfundojë vetëm me marrëveshje në mes të dyja palëve (huadhënësit dhe huamarrësit);
- 1.19. **Llogaria e Kujdestarisë** - nënkupton llogaria e ruajtjes së letrave me vlerë në sistemin Depo X në BQK ku letrat me vlerë të qeverisë mbahen në formë elektronike në llogaritë individuale të investitorëve;
- 1.20. **Data e Shlyerjes** - Dita kur realizohet pagesa dhe zhvendoset kolaterali i përcaktuar nga huamarrësi tek huadhënësi. Shlyerja e zakonshme për një marrëveshje Repo është data e transaksionit plus një ditë pune, apo T+1;
- 1.21. **Norma e Kthimit gjer në maturim**- nënkupton norma vjetore e kthimit ose vlera aktuale e pagesave të mjeteve monetare të obligacionit qeveritar deri në maturim, e shprehur në përqindje;
- 1.22. **Kurba e Normës së Kthimit (Yield-i)** - nënkupton një linjë e cila përcakton pikat e normave të interesit të letrave me vlerë në një periudhë të caktuar kohore, të cilat kanë kualitet të barabartë kreditor, por data të ndryshme të maturimit.

Neni 3

Aplikimi për Huamarrje të Mbështetur me Kolateral

1. Huamarrësi i cili aplikon për hua duhet të kontaktojë BQK-në përmes komunikimit elektronik nëpërmjet sistemit elektronik Depo X dhe postës elektronike. Huamarrësi duhet t'i ofrojë BQK-së informacionet e mëposhtme:
 - 1.1. Datën e propozuar të fillimit dhe datën e përfundimit të marrëveshjes Repo;
 - 1.2. Një përshkrim formal i letrave me vlerë që huamarrësi i propozon si kolateral;
 - 1.3. Shuma nominale e kolateralit të huamarrësit që do të përdoret;
 - 1.4. Marrëveshje nga huamarrësi dhe huadhënësi për normën Repo;

- 1.5. Pranimi nga huamarrësi i vlerësimit të kolateralit të BQK-së dhe margjinës që do të aplikohet.
2. Inicimi i kërkesës për aplikim për hua bëhet nga ana e huamarrësit sipas marrëveshjes në mes të huamarrësit dhe BQK-së. Pas pranimit të kërkesës për hua, kolaterali i ofruar nga huamarrësi do të bartet në formë elektronike në llogarinë për Repo të BQK-së.
3. BQK do të autorizojë transaksionin për bartje të kolateralit sipas marrëveshjes me huamarrësin, me ç'rast kolaterali i bartur do të transferohet në llogarinë për Repo të BQK'së dhe do të qëndrojë në këtë llogari në pajtim me kohëzgjatjen e përcaktuar sipas marrëveshjes së riblerjes.

Neni 4 **Vlerësimi i Kolateralit**

1. BQK do të ofrojë informata lidhur me vlerësimet e letrave me vlerë të tregut në faqen e saj të internetit për të gjitha letrat me vlerë të pamaturuara (aktive) të Qeverisë së Kosovës. Këto vlerësime do të shprehen në formë të normës së kthimit (yield) për secilën kategori të maturimit nga një (1) deri në dhjetë (10) vjet.
2. Maturimi i një letre me vlerë përcaktohet duke zbritur datën e fillimit të marrëveshjes Repo nga data e maturimit të letrës me vlerë. Rrumbullakimi i ditëve dhe muajve të pjesshëm do të përdoret për të përcaktuar kategorinë e përshtatshme të vlerësimit në të cilën do të bëjë pjesë kolaterali i ofruar. (Shembull, data e fillimit të marrëveshjes Repo nga 1 shkurt 2019, data e maturimit të letrës me vlerë me 1 maj 2021, diferenca e maturimit prej 2 vjetësh e 3 muajsh, e vendos letrën me vlerë në kategorinë 2 vjeçare për qëllime të vlerësimit të tregut.)
3. Vlerësimet e normës së kthimit (yield) do të jenë në formën e një kurbe të yield-eve, duke ofruar yield-et për secilën nga dhjetë kategoritë e ndryshme të maturimit. Kurba e yield-eve të interpoluara ose lineare do të bazohet në rezultatet e ankandit të fundit të bonove të thesarit dhe obligacioneve qeveritare të tregtueshme në tregun primar dhe të shpallura nga Ministria e Financave. BQK gjithashtu do të përfshijë të dhënat e çmimeve të tregut sekondar në llogaritjet dhe metodologjinë e kurbës së yield-it.

Neni 5 **Vendosja e Çmimit të Kolateralit të Huamarrësit**

1. Bonot e thesarit dhe obligacionet qeveritare kanë formulat e tyre specifike të çmimit për përcaktimin e vlerësimit të çmimit të përcaktuara sipas Rregullores së Ministrisë së Financave (MeF) për tregun primar dhe sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës. Në huadhënien e mbështetur me kolateral do të aplikohet çmimi i plotë aktual për të gjitha kolateralet e obligacioneve qeveritare.
2. Çmimi i bonove të thesarit përcaktohet nga norma e kthimit/yield-i të përcaktuar sipas nenit 4 të kësaj rregullore, data e shlyerjes (data e fillimit të Repo) dhe data e maturimit të Bonos së Thesarit. Këto të dhëna përcaktojnë çmimin e letrës me vlerë. Sapo të dihet çmimi i bonos së thesarit, ai

shumëzohet me shumën nominale të letrave me vlerë për të marrë një vlerësim të tregut për kolateralin e duhur.

3. Çmimi i obligacioneve qeveritare përcaktohet nga norma e kthimit/yield-i të përcaktuar sipas nenit 4 të kësaj rregullore, data e shlyerjes (data e fillimit të Repo), data e maturimit të obligacionit dhe norma e kuponit të obligacionit. Pasi të përcaktohet çmimi i tregut të një obligacioni, i shtohet interesi i akumuluar për të përcaktuar çmimin e plotë aktual të obligacionit. Çmimi i plotë i tregut shumëzohet me shumën nominale të letrave me vlerë për të marrë një vlerësim të tregut për kolateralin e duhur.

Neni 6

Kërkesa për Margjinë të Kolateralit të Huamarrësit

1. Një margjinë ose diferencë vendoset në vlerësimin e tregut të kolateralit në një marrëveshje Repo. Margjina vendoset për të mbrojtur huadhënësin nga luhajtjet e vogla të tregut gjatë kohëzgjatjes së marrëveshjes Repo. Kërkesat e margjinës caktohen në përqindje të shumës nominale të kolateralit të specifikuar.
2. BQK do të vendosë një listë për margjinë në faqen e saj të internetit, përqindja e margjinës do të vendoset dhe vlen për secilën kategori të vlerësimit vjetor të tregut.

Neni 7

Vlerësimi Neto i Kolateralit të Huamarrësit

1. Vlerësimi neto i tregut për kolateralin e letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës do të jetë si më poshtë:
 - 1.1. Bono e thesarit: vlerësimi i tregut duke mos përfshirë kërkesën për margjinë;
 - 1.2. Obligacioni qeveritar: vlerësimi i çmimit të plotë aktual duke mos përfshirë kërkesën për margjinë.
2. Vlerësimi neto do të rumbullakohet me marrëveshjen ndërmjet huadhënësit dhe huamarrësit.

Neni 8

Shlyerja sipas Marrëveshjes Repo

1. Në datën e fillimit të marrëveshjes Repo, BQK do të kreditojë fondet e duhura në llogarinë rezervë të huamarrësit në BQK. Në të njëjtën kohë BQK-ja do ta marrë kolateralin e specifikuar nga llogaria e regjistrimit të huamarrësit dhe do ta marrë në posedim të plotë.
2. Në datën e përfundimit të marrëveshjes Repo, BQK automatikisht do të ngarkojë llogarinë rezervë të huamarrësit në BQK për shumën e kryegjësë dhe interesit të marrëveshjes Repo. Në të njëjtën kohë do të ri-depozitojë në llogarinë e regjistrimit të huamarrësit kolateralin e specifikuar.

Neni 9

Rinovimi i Marrëveshjes Repo

1. Qëllimi i huadhënies së mbështetur me kolateral është që të ndihmojë huamarrësit në menaxhimin efikas të kërkesave të tyre të likuiditetit në një afat të shkurtër kohor dhe huamarrësi mund të paraqesë kërkesë për rinovim të marrëveshjes Repo.
2. Nëse konstatohet se aplikimi i vazhdueshëm në huadhënie të mbështetur me kolateral nga një huamarrës shkel qëllimin sipas nenit 1 të kësaj rregullore, atëherë BQK nëse e vlerëson të arsyeshme mund të refuzojë rinovimin e marrëveshjes Repo.

Neni 10

Fondi në dispozicion për Huadhënien e Mbështetur me Kolateral

Bordi Ekzekutiv i BQK-së do të përcaktojë një shumë të mjetëve të disponueshme për këtë qëllim.

Neni 11

Ndryshimet e Maturitetit të Letrave me Vlerë të Qeverisë

Vlerësimet e çmimeve dhe kërkesat për margjinë të vendosura nga BQK në faqen e saj të zyrtare te internetit janë në përputhje me strukturën aktuale të maturitetit të letrave me vlerë të lëshuara nga Qeveria e Kosovës. Për instrumentet e reja të emetuara nga Qeveria e Kosovës me maturitet mbi dhjetë (10) vite, BQK-ja do të përcaktojë në mënyrë të përshtatshme vlerësimin dhe diferencën (margjinën) për kolateralin e këtyre instrumenteve.

Neni 12

Shtojca

Shtojcë e kësaj Rregulloreje është Metodologjia e Përcaktimit të Çmimeve të Letrave me Vlerë të Qeverisë së Kosovës.

Neni 13

Hyrja në Fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e miratimit të saj.

Flamur Mrasori

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Shtojca: Metodologjia e Përcaktimit të Çmimeve të Letrave me Vlerë të Qeverisë së Kosovës

PËRCAKTIMI I ÇMIMIT TË KOLATERALIT PËR BONO THESARI

Informacionet dhe kriteret e ofruara të përcaktuara sipas Nenit 3 të kësaj Rregulloreje

Norma Repo e BQK :	0.10% (Norma ref. e BQE 0.00% + rregullimi i diferencës. prej 0.10%)
Data e fillimit	1 Shkurt 19
Data e mbarimit	11 Shkurt 19
Kodi i Ankandit	KV020-18
Data e maturimit	4 Dhjetor 19
Vlera Nominale	2,000,000

Informacionet e përcaktuar nga Neni 4

Data e fillimit	1 Shkurt 19
Data e maturimit	4 Dhjetor 19
Ditët deri në maturim	306 dite
306 ditë rrumbullakohen në kategorinë	1 vit
Vlerësimi i Tregut -1 vit	0.80%

Informacionet e përcaktuar nga Neni 5 & 6

Çmimi i tregut	0.993245928
Vlera nominale	2,000,000
Çmimi para margjinës	1,986,491.86
Margjina 1%	- 20,000.00
Vlera neto	1,966,491.86
Rrumbullakimi i vlerësimit neto	1,966,000.00

Më 1 shkurt 2019, BQK krediton llogarinë e rezervës së huamarrësit për vlerën € 1,966,000.00 dhe njëkohësisht zhvendos vlerën prej € 2,000,000.00 të Bonove të Thesarit (për t'u paguar me 4 dhjetor 19) nga llogaria e regjistrit të letrave me vlerë të huamarrësit, duke marr në posedim të plotë kolateralin.

Më 11 shkurt 2019, BQK-ja automatikisht ngarkon llogarinë e rezervës së huamarrësit në vlerë €1,966,054.61, që përfaqëson kryegjësë prej €1,966,000.00 dhe interesin prej €54,61. BQK në të njëjtën kohë do kthej posedimin e Bonove të Thesarit (për t'u paguar me 4 dhjetor 19) prej € 2,000,000.00 në llogarinë e regjistrit të letrave me vlerë të huamarrësit.

PËRCAKTIMI I ÇMIMIT TË KOLATERALIT PËR OBLIGACIONET QEVERITARE

Informacionet dhe kriteret e ofruara nga Neni 3

Norma Repo e BQK:	0.10% (Norma ref. e BQE 0.00% + rregullimi i diferencës prej 0.10%)
Data e fillimit	1 Shkurt 19
Data e mbarimit	11 Shkurt 19
Kodi i Ankandit	KV011-17
Data e maturimit	4 Korrik 22
Norma e Kuponit	1.20%
Vlera nominale	2,500,000

Informacionet e përcaktuar nga Neni 4

Data e fillimit	1 Shkurt 19
Data e maturimit	4 Korrik 22
Ditët deri në maturim	3.4 vite
3.4 vite rrumbullaksohen në kategorinë	3 vite
Vlerësimi i Tregut - 3 vite	2.70%

Informacionet e përcaktuar nga Neni 5 & 6

Çmimi i tregut	0.9512690
Vlera nominale	2,500,000.00
Çmimi para margjinës	2,378,172.46
Interesi i akumuluar	2,320.44
Vlera totale e tregut	2,380,492.90
Margjina 5%	- 125,000.00
Vlera neto	2,255,492.90
Rrumbullaksimi i vlerësimit neto	2,255,000.00

Më 1 shkurt 2019, BQK krediton llogarinë e rezervës së huamarrësit për vlerën € 2,255,000.00 duke zhvendosur njëkohësisht €2,500,000.00 të Obligacioneve Qeveritare (për t'u paguar me 4 Korrik 2022) nga llogaria e regjistrimit të letrave me vlerë të huamarrësit, duke marrë kështu në posedim të plotë kolateralin.

Më 11 shkurt 2019, BQK-ja automatikisht ngarkon llogarinë e rezervës së huamarrësit në vlerë € 2,255,062.64, që përfaqëson kryegjësë prej € 2,255,000.00 dhe interesin prej € 62,64. BQK në të njëjtën kohë kthen posedimin e obligacioneve qeveritare (për t'u paguar me 4 Korrik 2022) në vlerë € 2,500,000.00 në llogarinë e regjistrimit të letrave me vlerë të huamarrësit.

**SHEMBULL I KURBËS SË PËRCAKTIMIT TË ÇMIMIT TË KOLATERALIT PËR LETRA ME VLERË TË QEVERISË NE UEB
FAQEN E BQK-SË DHE LISTA PËR MARGJINË E CILA DO TË PUBLIKOHET NGA BQK**

Vlerësimi i Kolateralit për 24 Janar 2019		
Viti	Vlera e Yield-it	Margjina
1	0.80%	1.00%
2	1.70%	5.00%
3	2.70%	
4	3.70%	
5	4.70%	
6	5.70%	8.00%
7	6.70%	
8	7.70%	
9	8.70%	
10	9.70%	

